**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE SHKODËR**
**NOTER FLLADINA F. KASTRATI**

V202104039008485365O

**DATE 28/05/2021**
**NR REP 1786**

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 28/05/2021, para meje Notere FLLADINA F. KASTRATI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Shkoder, Rruga "Don Bosco", Ndertesa "Pysqyli", Bashkia Shkoder,, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUESI**:
Kleiti Hilaj, atësia Gacalin, amësia Vida, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Kole Heqimi 03310225; Nd. 43; H. 2; Shkodër; Shkodër; 4001; Shkodër, lindur më 26/07/1994, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036816920 dhe nr. personal J40726096W , .

**NËNSHKRUESI:**
Aldo Gega, atësia Rrok, amësia Verë, shtetas Shqiptar, lindur në Boge, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë Pemtorja 03460179; Nd. 7; H. 1; Rrethinat; Shtoj I Ri; 4015; Shkodër, lindur më 04/06/1994, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034659393 dhe nr. personal J40604044T , .

Shtetasit e mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statut **AVIA-F sh.p.k dhe AKT Themelimi AVIA-F sh.p.k**
", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

FLLADINA F. KASTRATI

# AKTI I THEMELIMIT

# DHE

# STATUTI

# I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

# AVIA-F sh.p.k.

## I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA DHE OBJEKTI I SHOQERISE

### Neni 1

### Emertimi

1.1. Emertimi tregtar i shoqerise eshte "AVIA-F" sh.p.k.

1.2. "AVIA-F" shpk eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Aktiviteti i kesaj shoqerie rregullohet nga ky statut dhe nga Ligji nr. 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

### Neni 2

### Selia

2.1. Selia e shoqerise eshte ne adresen: Shkoder, rruga Kole Heqimi, banesa nr 43.

2.2. Ajo mund te hape dege dhe/ ose filiale ne te gjitha rrethet e vendit si edhe jashte tij.

### Neni 3

### Vula

3.1. Shoqeria ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj tregtar.

### Neni 4

### Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatje e shoqerise eshte e pacaktuar.

## Neni 5

## Objekti

5.1 Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:

**Ne fushen e ndertimit shoqeria kryen:** Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin e veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, te gjitha restaurimet, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas nenit 142 te Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur.

**Ne fushen e turizmit shoqeria kryen**: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin e infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezirnin njerezor me karakter pushues, argetues, dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere, per realizimin e hoteleri, fshate/qendra turistike, e te tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem, si bar- restorante, qendra estetike, krijimin e agjencive turistike e te tjera.

**Ne fushen e transportit, shoqeria kryen**: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin e infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave brenda dhe jashte territorit te vendit si dhe tranzitimin e tyre pergjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Shoqeria kryen dhe duke mos u kufizuar vetem ne, aktivitetet e meposhtme:

Sipermarrje dhe realizim i ndermjetesimit dhe transportit, ngarkirnit dhe shkarkimit te mallrave me tren e automjete ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe te personave te trete. Pritje dhe levrim i ngarkesave nga dhe per ne stacionet e destinuara; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim dhe levrim i ngarkesave nga dhe per transport hekurudhor dhe tokesor; Sipermarrje dhe realizimi i puneve te ndermjetesimit, agjencise dhe transportit ne interes te vete shoqerise ose te paleve te treta porositese.

**Ne fushen e mjedisit** shoqeria kryen Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, per realizimin e mbrojtjes dhe/ose permiresimit si dhe rehabilitimit te kushteve te mjedisit rrethues; perpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje te cdo lloji tjeter, trajtimi i ujrave industriale, projektimin, mbikqyrjen ne fushen e kerkimit dhe shfrytezimit te lendes drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe

trajtimin e tokave te kripura e kenetave si dhe cdo veprimtari qe ka rendesi per shoqerine.

**Ne fushen e sherbimeve** shoqeria kryen Konsulence teknike ne fusha te ndryshme, supervizion, menaxhimet dhe studimet e te gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marreveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo forma te tjera, veprimtari komisionere, servis per tipet e ndryshme te automjeteve, perfaqesim, si dhe veprime te tjera te porositura nga te tretet te lejuara nga legjislacioni shqiptar; riparimin dhe remontet e mesme dhe kapitale te makinave elektrike te cdo tipi fuqie e tensioni, te motorrave dhe transformatoreve elektrike, transformatoreve te tensionit te larte, dhe te gjitha paisjeve elektrike; konsulence, revizion, ekspertize, vleresime te kapitaleve dhe gjendjes, planbizneseve, projekte zhvillimi dhe studime te efektiviteteve ekonomike, percaktimi i prioriteteve ne fusha te ndryshme te ekonomise etj. Administrim fondesh dhe/ose investimesh; Sherbime ne fushen e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme, duke perfshire pa u kufizuar qiradhenie, administrim, menaxhim, mirembajtje, riparim, ndermjetesim etj, per vete shoqerine apo te tretet, ne territorin e Republikes se Shqiperise apo jashte saj.

**Ne fushen e tregetise** shoqeria kryen Tregtimin dhe import-eksportin me shumice e pakice, te te gjitha mallrave me ose pa akcize, duke perfshire, por pa u kufizuar ne, industriale, ushqimore, mjekesore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake, te ndertimit, hidrosanitare, hidraulike, mekanike, tuba te te gjitha llojeve dhe rekorderi per ujesjellesa, shtylla elektrike elektropompa, elektrike, elektronike, materiale kancelarie, veshje pune profesionale, vegla pune dhe makineri te te gjitha llojeve, mobilje dhe aksesore mobilerie, kozmetike, konfeksione, te mediave, te mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, te makinerive,te mineraleve, te lendes drusore, te lendeve te para dhe te perpunuara per procesin e prodhimit; tregtimin e pasurive te luajtshme e te paluajtshme, shitblerjen e tokes, tregtimin e mallrave te gatshme e gjysme te gatshme; shitblerje letrash me vlere; tregtimin me pakice te naftes, gazit natyror dhe nenprodukteve te tyre; vajra dhe lubrifikante, goma per te gjithe mjetet, ushtrimi i aktivitetit te bar-restorant, dhe njesive te tjera te tregtimit te pijeve alkoolike dhe produkteve ushqimore te gatshme dhe gjysme te gatshme. Kryerja e punimeve per te gjitha materialet qe tregton.

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, me qellim arritjen e objektivave te mesiperme, shoqeria mund:

a) te perdore (per vete) te gjitha sherbimet dhe prodhimet brenda objektit te veprimtarise se saj, te ofruara dhe/ose prodhuara nga ajo vete apo te Tretet.

b) te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;

Shoqeria do te kryeje cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per te favorizuar ate. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes.

## II. ORTAKET, KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

### Neni 6

### Ortaket

6.1. Ortak i shoqerise "AVIA-F" sh.p.k. jane :

z. Kleiti Hilaj.

z. Aldo Gega

### Neni 7

### Kapitali i Rregjistruar

7.1. Vlera e Kapitalit te rregjistruar eshte 100.000 (njeqindmije) Leke. Kapitali ndahet ne 2 (dy) kuote te barabarta, me vlere prej 50.000 (pesedhjetemije) Leke seicila, te nenshkruara plotesisht nga ortaket Kleiti Hilaj dhe Aldo Gega.

7.2. Pjeset nuk materializohen ne letra me vlere te tregtueshme, por vertetohen me ane te Certifikatave nominative te leshuara nga shoqeria.

7. 3. Cdo kuote e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.

7.4. Ortaku i shoqerise perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

### Neni 8

### Transferimi

8.1. Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve (ne rast se numri i tyre ne te ardhmen do te shtohet).

8.2. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek persona te trete dhe/ ose transferimi i pjeseve ne rruge trashegimie, si dhe transferimi tek persona te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri iu nenshtrohet ketyre rregullave:

a. Transferuesi apo trasheguesi ne rastin e transferimit ne rruge trashegimie, duhet t'i njoftoje shoqerise numrin e pjeseve qe do te transferohen, cmimin e shitjes ne rast shitjeje, si dhe emrin, mbiemrin dhe adresen e personit te cilit i transferohen pjeset.

b. Transferimi duhet te miratohet nga Asambleja e ortakeve brenda tre muajve nga dita e njoftimit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda afatit tre mujor, miratimi quhet i dhene.

c. Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim te vlefshem per transferimin vetem kur marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 1/2 e numrit total te votave. Asambleja miraton transferimin vetem me shumicen e ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten ¾ (tre te katertat) e votave.

d. Ne rast se shoqeria refuzon transferimin, brenda tre muajve nga data e refuzimit, ortaket duhet t'i blejne pjeset e propozuara per transferim. Cmimi i shitjes eshte vlera kontabel e pjeseve (book value). Nese disa ortake jane te interesuar njeheresh ne blerjen e pjeseve, e drejta e tyre eshte proporcionale me numrin e pjeseve qe ata zoterojne. Ne rast se asnje ortak nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Asambleja duhet te vendose, me shumicen e ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten ¾ (tre te katertat) e votave, nese: 1. pjeset do t'i shiten personit te propozuar nga transferuesi me cmimin e rene dakort midis tyre; 2. pjeset do t'i shiten nje personi tjeter te trete me cmimin e rene dakort me kete person por jo me pak se vlera kontabel e tyre.

8.3. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, ne cdo rast, duhet te vertetohet me akt noterial.

**Neni 9**

**Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

9.1. Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim te vlefshem per zmadhimin e kapitalit themeltar mund te marre vendim te vlefshem per zvogelimin e kapitalit themeltar vetem kur marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se ½ e numrit total te votave. Kapitali themeltar zmadhohet me vendim te ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten ¾ (tre te katertat) e votave.

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.

9.3. Ortaket kane te drejten e rritjes ne menyre proporcionale (ne te njejten mase me pjeset e kapitalit qe ata perfaqesojne). Askush nuk mund te favorizohet apo te disfavorizohet nepermjet zmadhimit te kapitalit (parimi i trajtimit te barabarte).

9.4. Megjithate, ne asnje rast, ortaket qe perfaqesojne shumicen e cilesuar sipas pikes 11.8. te nenit 11 dhe pikes 9.1. te nenit 9 te ketij statuti, nuk mund te detyrojne nje apo disa ortake te minorances per te rritur angazhimin e tyre ne kapitalin themeltar

te shoqerise. Ne kete rast, kapitali rritet ne menyre proporcionale ndermjet ortakeve qe kane pranuar zmadhimin e tij.

9.5. Ne rast zmadhdimi te kapitalit me ane te kontributeve ne para, te gjitha pjeset e reja duhet te nenshkruhen dhe shlyhen teresisht. Ato duhet te depozitohen nga nenshkruesit per llogari te shoqerise. Terheqja e fondeve te reja mund te behet vetem pas regjistrimit te zmadhimit te kapitalit ne Regjistrin Tregtar.

### Neni 10

### Zvogelimi i Kapitali Themeltar

10.1. Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim te vlefshem per zvogelimin e kapitalit themeltar vetem kur marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se ½ e numrit total te votave. Kapitali themeltar zmadhohet me vendim te ortakeve te pranishem qe perfaqesojne te pakten ¾ (tre te katertat) e votave.

10.2. Zvoglimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata perfaqesojne.

10.3. Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, brenda tre muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, ortaket qe perfaqesojne shumicen e cilesuar sipas pikes 11.8. te nenit 11 dhe pikes 10.1. te nenit 10 te ketij statuti, duhet te vendosin ose prishjen e shoqerise, ose zvoglimin e kapitalit me nje vlere me te madhe se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat, por pa e zbritur kapitalin nen shumen minimale, ne perputhje me nenin 70 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE

### Neni 11

### Asambleja e Ortakeve

11.1. Vendimet merren nga ortaku i vetem ose nga asambleja e ortakeve.

11.2. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe ne vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne keto mbledhje nga nje ortak tjeter ose nga nje mandatmbajtes i cili mund te votoje ne emer te atij qe perfaqeson.

11.3. Asambleja mblidhet ne menyre te rregullt dhe mund te thirret ne cdo kohe sipas parashikimeve te neneve 82, 83 dhe 84 te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

11.4. Asambleja thirret nga Kryetari i Asamblese ose ne mungese te tij, nga Administratori. Kryetari i Asamblese emerohet dhe ndryshohet nga Asambleja me shumice te thjeshte. Ai nuk eshte punemarres i shoqerise.

11.5. Kryetari i asamblese emeron nje person fizik, ortak ose jo, ne postin e sekretarit. Sekretari mban proces - verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga te gjithe ortaket e pranishem ne mbledhje.

11.6. Votimi eshte ne parim i hapur. Me kerkese te nje ose disa ortakeve te pranishem qe perfaqesojne me shume se gjysmen e votave, votimi eshte sekret.

11.7. Jane ne kompetencen e Asamblese dhe nuk mund t'i delegohen Administratorit, marrja e vendimeve per sa i perket:

a. ndryshimi i statutit;

b. riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi;

c. zmadhirni, zvoglimi i kapitalit;

d. miratimi i llogarive, raporti vjetor , inventaret, raporti i eksperteve kontabel te autorizuar;

e. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese;

f. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;

g. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;

h. te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe ose ky statut i japin shprehirnisht Asamblese;

11.8. Asambleja merr vendim me

a. shumice te thjeshte: me shume se ½ e votave te ortakeve pjesemarres, ose

b. shumice te cilesuar: me ¾ e votave te ortakeve pjesemarres - sipas parashikimit te nenit te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

11.9. Asambleja vendos me shumice te cilesuar ne lidhje me :

a. ndryshimin e statutit

b. transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek nje i trete c. zmadhimin apo zvoglimin e kapitalit themeltar

d. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

e. shperndarjen e fitimeve

11.10 Per cdo ceshtje tjeter, Asambleja vendos me shumice te thjeshte.

11.11. Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante, qe mbahet ne seline e shoqerise.

## Neni 12

## Administrimi

12.1. Shoqeria administrohet nga Administratori, emerimi i te cilit behet sipas rregullave te Ligjit Nr.9901, pjesa qe ben fjale per sh.p.k.-te. Administratori i Shoqerise eshte Z. Kleiti Hilaj dhe mandati i tij si Administrator eshte 5 vjet nga data e miratimit te ketij Statuti.

12.2. Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje ligjore, per shkelje te statutit apo per faje gjate administrimit te shoqerise.

## Neni13

## Kompetencat e Administrimit

13.1. Marredheniet midis administratorit/ve, kompetencat, te drejtat dhe detyrimet e tyre rregullohen nga Akti i Emerimit dhe Statuti.

13.2. Administratori/et ka keto kompetenca dhe detyra:

(a) te monitoroje dhe te supervizoje zbatimin e politikave te biznesit;

(b) me kerkese te Asamblese se Ortakeve te marre te gjitha masat ne kompetence te tij dhe ti zbatoje ato;

(c) te siguroje qe Shoqeria zbaton ligjet e aplikueshme per te dhe standartet e duhura te kontabilitetit;

(d) te ekzaminoje dhe te mbaje Librat e Shoqerise, dokumentat dhe asetet;

(e) te siguroje qe librat e auditit dhe te dhenat te tjera te kontrollohen te pakten nje here ne vit nga eksperti kontabel i autorizuar;

(t) cdo te drejte dhe kompetence tjeter per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te shoqerise, me perjashtim te atyre rasteve qe ligji dhe/ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese.

13.3 Administratori ka te drejte te caktoje nje ose disa persona te autorizuar per te realizuar pjeserisht apo plotesisht kompetencat dhe detyrat tij te administrimit.

**Neni 14**

**Eksperti kontabel i autorizuar**

14.1. Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar (person fizik apo shoqeri), Ai caktohet me vendim te Asamblese, me shumice te thjeshte.

## IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

**Neni 15**

**Viti financiar**

15.1. Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht viti i pare fillon ne diten e rregjistrimit dhe perfundon ne fund.

**Neni 16**

**Llogarite vjetore**

16.1. Llogarite vjetore, inventari; raporte mbi operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecuara te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel I autorizuar, miratohen nga asambleja e pergjithshme.

16.2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

**Neni 17**

**Fitimi**

17.1. Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha shpenzimet, si edhe fondet e lena rezerve per nxitje ekonomike, per investime per reklame tregtare etj, ndahen ndermjet ortakeve ne perputhje me perqindjen e kapitali themeltar qe ka secili ortak.

**Neni18**

**Bilanci**

18.1. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes .

## V. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUIDIMI

**Neni 19**

**Likuidimi**

19.1. Shoqeria prishet me vendim te asamblese me shumice te cilesuar dhe ne perputhje me ligjet ne Republiken e Shqiperise.

19.2. Ne rastin e prishjes se kompanise, ajo kryen procesin e likujdimit ne perputhje me ligjet ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

## VI. DISPOZITAT E FUNDIT

**Neni 20**

**Mosmarrveshjet**

20.1 Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder.

Me daten 28/05/2021, ne Shkoder, u hartua dhe u nenshkrua, me vullnetin e lire te Ortakve z. Kleiti Hilaj dhe Aldo Gega, ky Akt Themelimi dhe ky Statut i Shoqerise "AVIA-F" sh.p.k. ne perputhje me Nenin 230 te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, ne 5 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore.

**ORTAKU I SHOQERISE "AVIA-F" SHPK**

**KLEITI HILAJ**

**ALDO GEGA**